



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2582/Prot
4

Rrëshen më, 06 . 08 2025

V E N D I M

Nr. 58 datë 01. 08. 2025

**“PËR MIRATIMIN , VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA RËNIA E
ZJARRIT NË BANESËN E Znj. ELSA MARK BUSHI , LAGJE SHTANË, FSHATI
KODËR - RRËSHEN, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN”, BASHKIA MIRDITË
DHE PËRDORIM FOND I MBROJTJES CIVILE**

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr.45/2019 “Per mbrojtjen civile”, në ligjit nr.115/2024, “Per buxhetin e vitit 2025”, “Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, VKB nr.115 datë 27.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025”, dhe relacionin e komisionit të ngritur me Urdhër Nr. 248 datë 12.06.2025 nga Kryetari i Bashkisë për verifikimin e dëmeve, të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e Znj. Elsa Mark Bushi, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, *shqyrtimin e miratimin në mbledhjen e datës 28.07.2025, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit*, për t’a kaluar në seancën e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë dokumentacionin dhe preventivin e dëmit të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e Znj. Elsa Mark Bushi, nga i cili është shkaktuar djegia pjesërisht e banesës, si dhe janë dëmtuar orendi dhe paisjeve elektroshtëpiake, me një dëm total, i vlerësuar nga komisioni, në masën **326,162.56 lekë (treqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë e gjashtë) lekë**, nga ku:
 - a. Preventivi i vlerësimit nga ana materialeve ndërtimore: **137 662.56 lekë**,
 - b. Preventivi i vlerësimit të dëmeve në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake: **188 500 lekë**.

ADRESA SHIESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 esh.bashkiamirdite.gov

2. Bashkia Mirditë, nga fondet e kushtëzuara të mbrojtjes civile akordon ndihmë financiare **50%** të vlerës së dëmit Znj. Marë Preng Sinanaj, në masën **163 081 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e një)** lekë, përdorimi i fondit si më poshtë:

▪ **Përdorim fondi, Mbrojtje Civile; (Gr. 17 Tit. 10910 Kap. 1 Art. 604 kod prod 91707AB), për shumën 163 081 lekë**

3. Dosja e plotë e dokumenteve; (relacion, urdhër, procesverbal - konstatimi, prevetivat, planimetria e banesës dhe vërtetim rënie zjarri), *bashkëlidhur pjesë përbërse e këtij vendimi*
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë, (Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksat & Agjensia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave)

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.


SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR

Aleksandër PICAKU



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 ee@bashkiamirdite.gov



Gjithopoli

**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2582 / Prot.
3

Rrëshen, me 14/07 /2025

P/V E N D I M

Nr. 61 datë 14.07.2025

**“PËR MIRATIMIN, VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA RËNIA E
ZJARRIT NË BANESËN E Znj. ELSA MARK BUSHI, FSHATI SHTANË, KODËR -
RRËSHEN, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN”, BASHKIA MIRDITË DHE
PËRDORIM FOND I MBROJTJES CIVILE**

Mbështetur në ligjin 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr.45/2019 "Per mbrojtjen civile", në ligjin nr.115/2024, "Per buxhetin e vitit 2025", "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", VKB nr.115 datë 27.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025", dhe relacionin e komisionit të ngritur me urdhër Nr. 248 datë 12.06.2025 nga Kryetari i Bashkisë për verifikimin e dëmeve, të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e Znj. Elsa Mark Bushi, këshilli i Bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë;

V E N D O S I:

1. Të miratojë dokumentacionin dhe preventivin e dëmit të shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e Znj. Elsa Mark Bushi, nga i cili është shkaktuar djegia pjesërisht e banesës, si dhe janë dëmtuar orendi dhe paisjeve elektroshtëpiake, me një dëm total, i vlerësuar nga komisioni, në masën **326,162.56 lekë (treqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë e gjashtë) lekë**, nga ku:
 - a. Preventivi i vlerësimit nga ana materialeve ndërtimore: **137,662.56 lekë**,
 - b. Preventivi i vlerësimit të dëmeve në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake: **188,500 lekë**.
2. Bashkia Mirditë nga fondet e kushtëzuara të mbrojtjes civile akordon ndihmë financiare 50% të vlerës së dëmit Znj. Elsa Mark Bushi, në masën **163,081 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e një) lekë**, përdorimi i fondit si më poshtë:

ADRESA: SHESHI "ABAT DOCTI" RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 bashkiamirdite.gov

*Fondi mbrojtje civile(Gr. 17 Tit. 10910 Kap.1 Art. 604 kod prod 91707AB)për shumën
163,081 lekë*

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

*Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë
17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni
i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

SEKRETARI

KRYETARI

Gaspër TOPOLLAJ

Aleksandër PICA KU

Paraqiten projektin

Dr. AIKE:

F.Vorfi

Dr.Juridike, prok, protokoll:

M. Doda

Dr./zhvill ek dhe tatim taksat:: V.Gjoka



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov



BASHKIA MIRDITË

Nr. 2582 / Prot.
2

Rrëshen, me 14 / 07 /2025

RELACION

**PËR PROJEKT-VENDIMIN PËR "MIRATIMIN DHE VLERËSIMIN E DËMEVE
TË SHKAKTUARA NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESËN E Znj. ELSA MARK BUSHI,
FSHATI SHTANË, KODËR - RRËSHEN, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN"**

Drejtuar : Këshillit të Bashkisë Mirditë

Të nderuar këshilltarë,

Me datën 06.06.2025 në Fshatin Shtanë, Kodër - Rrëshen, të NJ.A Rrëshen, në banesën e Znj. Elsa Mark Bushi ka rënë zjarr duke e djegur pjesërisht atë ku i janë dëmtuar orendi dhe paisje elektroshtëpiake si dhe janë konstatuar dëme nga ana ndërtimore.

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe të VKM Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, kreu 111, pika 1 gërma b" dhe me urdhër të Kryetarit të Bashkisë me Nr. 248 datë 12.06.2025 u ngrit komisioni për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën Znj. Elsa Mark Bushi. Është mbajtur proces-verbali i konstatimit, evidentimi i subjektit të dëmtuar, ku në banesën e shtetasit Elsa Mark Bushi nga rënia e zjarrit u konstatua: është djegur kuzhina me të gjitha pasisjet elektroshtëpiake, perde, tavolina, karrige, ka dëmtime të rrjetit elektrik, dëmtime suvatimi, dyer dhe dritare të dëmtuara, prezence tymi në sallon dhe koridor, etj ku më të detajuara jepen në procesverbalin e konstatimit, preventivin e vlerësimit të dëmeve në orendi, pajisje, elektroshtëpiake si dhe në preventivin në dëmet nga ana ndërtimore. Preventivi i vlerësimit të dëmeve në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake është **188,500 lekë**. Preventivi i vlerësimit të dëmeve nga ana materiale ndërtimore është **137,662.56 lekë**.

Vlera totale e dëmit të shkaktuar në banesë është **326,162.56 lekë**.

Pasqyrimi i djegies së banesës shoqërohet me fotografi si dhe vërtetimin për rënien e zjarrit nga Stacioni i MZSH-së Bashkia Mirditë.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin !

Hartuan projektin:

Drejtori AIKE: Frederik VORFI

Përgj/ Sekt. EC: Ilir GJINI

KRYETARI I BASHKISË
ALBERT MËLYSHI

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË

Nr. 2215/1 Prot.

Rrëshen, me 12/06/2025

URDHËR

Nr. 248 Datë 12.06.2025

“ MBI NGRITJEN E KOMISIONIT PËR VERIFIKIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESËN E Znj. ELSA BUSHI, FSHATI SHTANË, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN”

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe të VKM Nr. 329, dt. 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”. Kreu III, pika 1, germa “b”.


URDHËROJ:

1. Të ngrihet komisioni për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e **Z. Elsa Bushi**, Fshati Shtanë, Njësia Administrative Rrëshen.
2. Përbërja e komisionit të jetë:

1. Gjin MANDREJA	Kryetar	Administrator i NJ. A Rrëshen
2. Mëhill PAÇUKU	Anëtar	Ing. Emergjencia Civile
3. Daisler PEPA	Anëtar	Ing. D.P.ZH.T
4. Kristjan MARKU	Anëtar	Specialist Taksash
5. Viktor VOKRRI	Anëtar	Specialist Emergjencia Civile

3. Vlerësimi i dëmeve të bëhet konformë , të VKM-s Nr. 329 datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Kreu III.
4. Të mbahet proces verbali i dëmeve të shkaktuara.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





BASHKIA MIRDITË
SEKTORI MZSH

Nr . 301 Prot

Datë.26. 06. 2025

V Ë R T E T I M
Për rënie zjarri

Vërtetojmë se me datën 06.06.2025 ora 11:05 kemi marrë njoftim nga Salla Operative Komisarjati Mirditë për ngjarjen zjarrit të rënë në banesën e shtetasit **Elsa BUSHI** në fshatin Shtane/ Koder Rreshen Njësia Administrative Rrëshen.
Vendi i zjarrit: Fshat Shtane Koder Rreshen , Njësia Administrative Rrëshen , Bashkia: Mirditë.

Nga konstatimi në vendin e ngjarjes deklarojmë se apartamenti në pronsi të shetasit **Elsa BUSHI** është djegur kuzhina pjesërisht, furra me pjatë si dhe aspirator, si dhe janë demtuar nga zjarri materiale të tjera dhe banesa në brendësinë e sajë si pasojë e zjarrit dhe tymit.

Ky vërtetim mbahet në tre kopje dhe përpilohet me kërkesën e të interesuarit me nr Prot 2215.
Datë 09.06.2025

SHEFI I SEKTORIT MZSH

AGIM LLESHAJ





BASHKIA MIRDITË

Nr. 2215 / Prot.

Rrëshen, me 01 / 07 / 2025

PROCES-VERBAL KONSTATIMI

I mbajtur sot me datë 12.06.2025 nga komisioni i ngritur me Urdhër nr. 248 dt. 12.06.2025 të Kryetarit të Bashkisë, për verifikimin e ankesës së Z. / Znj ELSA MARK BUSHI, banor i/e fshatit/qytetit SHTANË, Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë.

Në zbatim të VKM nr. 329 datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", dhe të Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë, komisioni konstaton këto dëme:

a. Nga ana ndërtimore:

PASTRIK LYERIE SALLONI MADH .

LYERIE TË KORIDORIT

DRITARE

DËRRE

SISTEMI ELEKTRIK.

MË TË DETAJUARA TEPEN NE PREVENTIVIN E
VLERESIMIT TË DËMEVE NGA ANA NDËRTIMORE.

b. Në orëndi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake:

NGA RENDI E ZJARRIT NE DANESE JANE DËMTUAR:

BUKE KUZHINE me 4, SOBE ME GAZ + ELEKTRIKE
GATIMI, 1 (një) FIRGORIFER cop 1 (një), ASPIRATOR cop 1 (një)
FURRE BUKE cop 1 (një), TAVOLINE BUKE cop 1 (një)
KARRIKE cop 5 (pesë), PERDE KOMPLET 2 (dy)
TAPET cop 1 (një)

Proces-verbali mbahet në 3 (tre) kopje dhe futet në dosje për veprim të mëtejshëm.

1. Gjin MANDREJA

KOMISIONI

2. Ing. Mëhili PAÇUKU

3. Ing. Daisler PEPA

4. Kristjan MARKU

5. Viktor VOKRRI

KRYETARI I BASHKISË
AIUT MËLYSHI

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al





BASHKIA MIRDITE

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE
ALBERT MELIŠHI



Nn. 2582/Pnot

PREVENTIV

Dt. 01.07.25

VLERESIM DEMI NGA ANA NDERTIMORE

PRONARI: ELSA BUSHI

ADRESA: KODER RRESHEN, N.J.A. RRESHEN, NR.PAS. _____, ZK. _____

OBJEKTI: BANESE 2+1

SHKAKU: RENIE ZJARRI, DEMTIME TE BRENDSHME

NR.R.	NR.ANAL.	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLERA
1	2.328	Patinim muri allci (stuko)	m2	50	418.64	20,932.00
2	2.383/2	F.V. Dyer te brendeshme druri cilesi e II-te.	m2	1.71	19,220.05	32,866.29
3	2.375/2a	Dritare d/alumini dyfi xh.	m2	1.62	11,444.81	18,540.59
4	2.404	Boje hidroplastike	m2	83	254.96	21,161.68
5	An.2	Dalje prize komplet	copë	3	8,148.00	24,444.00
6	An.1	Dalje drite komplet	copë	2	9,859.00	19,718.00
SHUMA Lek						137,662.56

Shenim: Cmimet jane sipas manualit te miratuar me VKM.Nr.216, date 13.04.2023.
Data e hartimit te preventivit 23.06.2025.

PREVENTIVOI
Ing.Mëhli PACUKU

KOMISIONI

Gjin MANDREJA Daisler PEPA Kristjan MARKU Viktor VOKRRI



BASHKIA MIRDITË

Nr. 2282. Prot

Rrëshen, me 01.07. 2025

PREVENTIV I VLERËSIMIT TË DËMEVE NË ORENDI, MOBILJE DHE PAISJE ELEKTROSHTËPIAKE

Familjari: Elsa Mark Bushi
Adresa e familjarit: Fshati Shtanë, Kodër Rrëshen, Njësia Administrative Rrëshen
Shkaku i dëmit: Rënie zjarri, dëmtim banese

Nr	Orendi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Bufe kuzhine	m/l	4 metra	18.000	72.000
2	Sobe gaz + elektrike gatimi	Copë	1 (një)	30.000	30.000
3	Frigorifer	Copë	1 (një)	25.000	25.000
4	Aspirator	Copë	1 (një)	9.500	9.500
5	Furrë buke	Copë	1 (një)	10.000	10.000
6	Tavolinë buke	Copë	1 (një)	12.500	12.500
7	Karrige	Copë	5 (pesë)	1.500	7.500
8	Perde komplet	Copë	2 (dy)	8.000	16.000
9	Tapete	Copë	1 (një)	6.000	6.000
	Shuma totale				188.500

Shuma totale 188.500 (njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë

Shënim: çmimet e mobiljeve, orendive janë marrë sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

PREVENTIVOI
Kristjan MARKU

KOMISIONI

Gjin MANDREJA

Ing. Mëhill PAÇUKU

Ing. Daisler PEPA

Viktor VOKRRI

KRYETARI
ALBERT MILLYSHI

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN


email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

PLANIMETRIA

BANESE ELSA BUSHI
KODER RRESHEN, N.J.A. RRESHEN.



PUNOI: Ing.Mehill RAÇUKU.